



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Në bazë të nenit 94 të Ligjit për arsimin e Lartë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 82/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 178/2021) dhe nenit 85 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Senati i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2022, miratoi këtë:

RREGULLORE

për rregullimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit të Tetovës

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Objekti i rregullimit

Neni 1

- (1) Me këtë Rregullore përcaktohen mënyra dhe procedura e realizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit të Tetovës (në tekstin e mëtejme: Universiteti), si dhe çështjet që lidhen me vendosjen, zhvillimin, zbatimin, bashkërendimin dhe monitorimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.
- (2) Me këtë Rregullore rregullohen në veçanti: organizimi dhe kompetencat në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar; format dhe fushat e bashkëpunimit ndërkombëtar; vendosja e bashkëpunimit institucional dhe lidhja e marrëveshjeve; mobiliteti ndërkombëtar i studentëve dhe i të punësuarve; pranimi i studentëve të huaj dhe i personelit mysafir; pjesëmarrja në programe, projekte, asociacione dhe rrjete ndërkombëtare; financimi, evidenca, monitorimi dhe raportimi, si dhe çështje të tjera me rëndësi për bashkëpunimin ndërkombëtar.

Neni 2

- (1) Bashkëpunimi ndërkombëtar i Universitetit realizohet në përputhje me ligjin, Statutin e Universitetit, këtë rregullore dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.
- (2) Gjatë realizimit të bashkëpunimit ndërkombëtar zbatohen edhe rregullat, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me marrëveshjet, programet, projektet dhe aktet e tjera ndërkombëtare në të cilat merr pjesë Universiteti, për aq sa ato nuk janë në kundërshtim me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me aktet e Universitetit.

Kuptimi dhe përkufizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 3

- (1) Bashkëpunimi ndërkombëtar, në kuptim të kësaj Rregulloreje, është një sistem veprimtarish institucionale, akademike, shkencore-kërkimore, profesionale dhe veprimtarish të tjera, të cilat Universiteti i realizon me institucione të arsimit të lartë



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

dhe institucione shkencore-kërkimore, organizata ndërkombëtare, rrjete dhe asociacione universitare, institucione publike dhe private, organizata profesionale dhe organizata të tjera të ngjashme, si dhe me subjekte jashtë vendit.

- (2) Bashkëpunimi ndërkombëtar mund të realizohet në nivel institucional, universitar, fakulteti, instituti ose në një nivel tjetër organizativ, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj, statut dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.

II. QËLLIMET DHE PARIMET E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

Qëllimet e bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 4

- (1) Bashkëpunimi ndërkombëtar i Universitetit realizohet me qëllim:

- avancimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe të veprimtarisë shkencore-kërkimore e profesionale;
- zhvillimin dhe avancimin e lidhjeve akademike, shkencore dhe institucionale me institucione të arsimit të lartë, institucione shkencore-kërkimore dhe institucione të tjera të ngjashme jashtë vendit;
- nxitjen dhe avancimin e mobilitetit dhe të shkëmbimit të studentëve, personelit akademik dhe administrativ;
- shkëmbimin e njohurive, arritjeve shkencore dhe profesionale, përvojave dhe praktikave të mira;
- zhvillimin dhe realizimin e veprimtarive dhe projekteve të përbashkëta arsimore, shkencore-kërkimore dhe profesionale;
- nxitjen e pjesëmarrjes së Universitetit në programe ndërkombëtare arsimore, shkencore-kërkimore dhe profesionale;
- zhvillimin e dialogut ndërkulturor dhe të bashkëpunimit ndërmjet bashkësive akademike;
- rritjen e dukshmërisë, njohjes dhe konkurrueshmërisë ndërkombëtare të Universitetit;
- avancimin e ndërkombëtarizimit të procesit arsimor, shkencor-kërkimor dhe profesional;
- krijimin e mundësive për përvetësimin dhe zhvillimin e kompetencave akademike dhe profesionale ndërkombëtare;
- vendosjen e partneriteteve afatgjata dhe të qëndrueshme me institucione dhe organizata të huaja; dhe
- kontributin në zhvillimin e arsimit të lartë, shkencës dhe shoqërisë nëpërmjet bashkëpunimit akademik dhe shkencor ndërkombëtar.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Parimet e bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 5

(1) Bashkëpunimi ndërkombëtar i Universitetit mbështetet në këto parime:

- parimi i ligjshmërisë - realizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit, si dhe me rregullat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme;
- parimi i lirisë dhe autonomisë akademike - respektimi i lirisë akademike, autonomisë institucionale dhe lirisë së krijimtarisë shkencore e profesionale;
- parimi i cilësisë - orientimi i bashkëpunimit ndërkombëtar drejt avancimit të cilësisë së arsimit, shkencës dhe punës profesionale;
- parimi i reciprocitetit dhe partneritetit - zhvillimi i bashkëpunimit mbi bazën e përfitimit të ndërsjellë, respektit, besimit dhe partneritetit të barabartë;
- parimi i mundësive të barabarta dhe mosdiskriminimit - siguri i mundësive të barabarta për pjesëmarrje në veprimtaritë e bashkëpunimit ndërkombëtar, pa diskriminim mbi asnjë bazë të përcaktuar me ligj;
- parimi i transparencës dhe llogaridhënies - siguri i informatave të qarta dhe të arritshme për mundësitë, procedurat dhe kriteret që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar, si dhe përgjegjësia për veprimtaritë e ndërmarra;
- parimi i objektivitetit dhe paanshmërisë - marrja e vendimeve në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht, të qarta dhe të zbatueshme;
- parimi i gjithëpërfshirjes - nxitja e pjesëmarrjes së kategorive të ndryshme të studentëve dhe të punësuarve në veprimtaritë e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- parimi i respektit të ndërsjellë - respektimi i dallimeve, veçorive kulturore, traditave akademike dhe vlerave të institucioneve partnere; dhe
- parimi i qëndrueshmërisë - zhvillimi i partneriteteve dhe veprimtarive afatgjata që krijojnë rezultate të qëndrueshme akademike, shkencore dhe institucionale.

Ndërkombëtarizimi

Neni 6

(1) Universiteti e zhvillon ndërkombëtarizimin si një proces të integruar, të orientuar drejt përfshirjes së dimensionit ndërkombëtar dhe ndërkulturor në veprimtarinë arsimore, shkencore-kërkimore, profesionale dhe institucionale.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

(2) Ndërkombëtarizimi realizohet në veçanti nëpërmjet:

- zhvillimit dhe avancimit të partneriteteve ndërkombëtare;
- rritjes së pjesëmarrjes në programe dhe projekte ndërkombëtare;
- avancimit të mobilitetit të studentëve dhe të punësuarve;
- zhvillimit të veprimtarive të përbashkëta studimore, shkencore-kërkimore dhe profesionale me partnerë të huaj;
- nxitjes së shkëmbimit të njohurive, përvojave dhe praktikave të mira;
- përfshirjes së dimensionit ndërkombëtar dhe ndërkulturor në mësimdhënie dhe në punën shkencore-kërkimore; dhe
- krijimit të kushteve për njohje dhe ndërlidhje më të madhe ndërkombëtare të Universitetit.

Cilësia, reciprociteti, transparenca dhe mundësitë e barabarta

Neni 7

- (1) Gjatë planifikimit dhe realizimit të veprimtarive të bashkëpunimit ndërkombëtar, Universiteti synon arritjen e një cilësie të lartë dhe të rezultateve të matshme akademike, shkencore-kërkimore dhe institucionale.
- (2) Bashkëpunimi ndërkombëtar vendoset dhe zhvillohet mbi parimin e reciprocitetit, duke marrë parasysh interesat dhe përfitimet e Universitetit dhe të institucioneve partnere.
- (3) Informacionet për mundësitë dhe procedurat e pjesëmarrjes në programe dhe veprimtari ndërkombëtare publikohen në mënyrë transparente dhe në kohë, në përputhje me natyrën e veprimtarisë dhe rregullat e programit ose marrëveshjes përkatëse.
- (4) Gjatë përzgjedhjes së pjesëmarrësve në veprimtaritë e bashkëpunimit ndërkombëtar zbatohen kriteret objektive, të përcaktuara paraprakisht, dhe sigurohen mundësi të barabarta, transparenca dhe mosdiskriminim.
- (5) Në realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar respektohen integriteti akademik, standardet profesionale, dinjiteti dhe të drejtat e të gjithë pjesëmarrësve.

III. ORGANIZIMI DHE KOMPETENCAT

Organizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 8

- (1) Bashkëpunimi ndërkombëtar i Universitetit organizohet, bashkërendohet dhe realizohet nëpërmjet organeve dhe njësive organizative të Universitetit, brenda kompetencave të tyre



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

të përcaktuara me ligj, Statut, Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.

(2) Në realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar marrin pjesë në veçanti:

- Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar (i autorizuar nga Rektori);
- njësia për bashkëpunim ndëruniversitar me universitetet brenda dhe jashtë vendit;
- fakultetet dhe institutet;
- njësitë e tjera organizative të Universitetit, në përputhje me kompetencat e tyre; dhe
- persona të tjerë të përcaktuar me aktet e Universitetit ose me aktet që rregullojnë formën konkrete të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Neni 9

(1) Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar e bashkërendon dhe e avanco bashkëpunimin ndërkombëtar të Universitetit, brenda kompetencave të përcaktuara me Statut dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.

(2) Prorektori, në veçanti:

- propozon masa dhe veprimtari për zhvillimin dhe avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- bashkërendon bashkëpunimin me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione shkencore-kërkimore, organizata ndërkombëtare, rrjete dhe asociacione;
- merr pjesë në inicimin dhe zhvillimin e partneriteteve ndërkombëtare;
- monitoron zbatimin e marrëveshjeve, programeve dhe projekteve në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- inicion dhe mbështet pjesëmarrjen e Universitetit në programe, projekte, rrjete dhe asociacione ndërkombëtare;
- propozon veprimtari për avancimin e mobilitetit të studentëve dhe të punësuarve;
- bashkëpunon me fakultetet, institutet dhe njësitë e tjera organizative gjatë planifikimit dhe realizimit të veprimtarive të bashkëpunimit ndërkombëtar;
- kujdeset për zbatimin e bashkërenduar dhe në kohë të veprimtarive në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar; dhe



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj, Statut, këtë Rregullore dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.
- (3) Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar përgjigjet për punën e tij në përputhje me Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.

Njësia për bashkëpunim ndëruniversitar me universitetet brenda dhe jashtë vendit

Neni 10

- (1) Njësia për bashkëpunim ndëruniversitar me universitetet brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të kompetencave të saj të përcaktuara me Rregulloren për organizimin e brendshëm, i kryen punët profesionale, administrative dhe bashkërenduese që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar të Universitetit.
- (2) Njësia, në veçanti:
 - përgatit dhe propozon planin e punës dhe kujdeset për realizimin e tij;
 - kujdeset dhe monitoron bashkëpunimin e Universitetit me universitetet brenda dhe jashtë vendit, si dhe dinamikën e realizimit të të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara me marrëveshje dhe vazhdimin e kohëzgjatjes së tyre;
 - harton projekt-tekstin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet brenda dhe jashtë vendit;
 - monitoron zbatimin e marrëveshjeve dhe të akteve të tjera për bashkëpunim ndërkombëtar dhe raporton në kohë për statusin e tyre;
 - kujdeset për anëtarësimin e Universitetit në Konferencën Evropiane të Rektorëve dhe Konferencën Botërore të Rektorëve si dhe monitoron programin e punës së këtyre institucioneve ndërkombëtare;
 - aplikon për përfshirjen aktive të Universitetit në projekte evropiane arsimore dhe shkencore-kërkimore;
 - merr pjesë në institucione shkencore dhe organizon tubime shkencore, simpoziume, seminare, këshillime dhe lloje të tjera tubimesh;
 - kujdeset për realizimin e bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë jashtë vendit, në aspektin e shkëmbimit të studentëve dhe personelit mësimor;
 - monitoron mundësitë e pjesëmarrjes së Universitetit në programe dhe thirrje ndërkombëtare dhe informon njësitë organizative përkatëse;
 - siguron mbështetje administrative për zbatimin e procedurave të mobilitetit ndërkombëtar;
 - mban dhe përditëson evidencën e marrëveshjeve, partneriteteve, programeve, projekteve dhe veprimtarive të realizuara ndërkombëtare;



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- siguron informacione për mundësitë e bashkëpunimit dhe mobilitetit ndërkombëtar dhe i publikon ato në mënyrën e përcaktuar me aktet e Universitetit;
- përgatit të dhëna dhe raporte për veprimtaritë në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar;
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Statutin e Universitetit.

Fakultetet dhe institutet

Neni 11

- (1) Fakultetet dhe institutet marrin pjesë në vendosjen dhe realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të veprimtarisë dhe kompetencave të tyre.
- (2) Fakultetet dhe institutet, në veçanti:
 - iniciojnë dhe propozojnë bashkëpunim me institucione të huaja të arsimit të lartë, institucione shkencore-kërkimore dhe institucione të tjera të ngjashme;
 - marrin pjesë në përgatitjen dhe realizimin e marrëveshjeve, projekteve, programeve dhe veprimtarive të tjera ndërkombëtare;
 - propozojnë dhe marrin pjesë në realizimin e veprimtarive të mobilitetit dhe shkëmbimit të studentëve dhe të punësuarve;
 - caktojnë persona përgjegjës ose koordinatorë për veprimtari konkrete të bashkëpunimit ndërkombëtar, kur kjo është e nevojshme;
 - sigurojnë mbështetje akademike dhe profesionale për pjesëmarrësit në veprimtaritë e bashkëpunimit ndërkombëtar;
 - ia dorëzojnë Njesisë të dhënat dhe informacionet e nevojshme për mbajtjen e evidencës dhe përgatitjen e raporteve; dhe
 - kryejnë edhe punë të tjera që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar, në përputhje me kompetencat e tyre.
- (3) Fakultetet dhe institutet i realizojnë veprimtaritë e bashkëpunimit ndërkombëtar në bashkërendim me Prorektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Njësinë, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj, Statut dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

IV. FORMAT DHE FUSHAT E BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR

Format e bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 12

- (1) Bashkëpunimi ndërkombëtar i Universitetit realizohet nëpërmjet formave të ndryshme të bashkëpunimit akademik, shkencor-kërkimor, profesional dhe institucional me institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione shkencore-kërkimore, organizata ndërkombëtare dhe subjekte të tjera të ngjashme.
- (2) Bashkëpunimi ndërkombëtar mund të realizohet në veçanti nëpërmjet:
 - vendosjes dhe zhvillimit të partneriteteve institucionale dhe lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit;
 - bashkëpunimit akademik dhe shkëmbimit të përvojave mësimore dhe akademike;
 - bashkëpunimit shkencor-kërkimor dhe realizimit të veprimtarive të përbashkëta shkencore-kërkimore;
 - mobilitetit ndërkombëtar dhe shkëmbimit të studentëve, personelit akademik dhe administrativ;
 - zhvillimit dhe realizimit të programeve të përbashkëta dhe ndërkombëtare të studimit;
 - organizimit dhe pjesëmarrjes në konferenca, kongrese, simpoziume, seminare, punëtori dhe ngjarje të tjera akademike e profesionale ndërkombëtare;
 - hartimit dhe publikimit të punimeve dhe botimeve të përbashkëta shkencore e profesionale;
 - shkëmbimit dhe ndarjes së literaturës shkencore e profesionale, informacioneve, materialeve mësimore dhe burimeve të tjera akademike;
 - angazhimit dhe pranimi të profesorëve mysafirë, studiuesve, profesionistëve dhe përfaqësuesve të tjerë të institucioneve partnere;
 - organizimit të veprimtarive të përbashkëta mësimore, shkencore dhe profesionale;
 - pjesëmarrjes në programe, projekte, rrjete, asociacione dhe forma të tjera të lidhjes ndërkombëtare;
 - shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira në fushën e arsimit të lartë, shkencës dhe veprimtarisë profesionale;
 - zhvillimit të formave të tjera të bashkëpunimit akademik dhe institucional me interes të përbashkët; dhe
 - formave të tjera të bashkëpunimit në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Fushat e bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 13

- (1) Bashkëpunimi ndërkombëtar mund të realizohet në të gjitha fushat e veprimtarisë së Universitetit, veçanërisht në:
- veprimtarinë e arsimit të lartë dhe veprimtarinë mësimore-arsimore;
 - veprimtarinë shkencore-kërkimore dhe zhvillimore;
 - veprimtarinë profesionale dhe aplikative;
 - zhvillimin dhe avancimin e programeve të studimit;
 - zhvillimin e metodave të mësimdhënies dhe praktikave digjitale arsimore;
 - zhvillimin profesional dhe akademik të studentëve dhe të punësuarve;
 - kulturën, artin dhe veprimtaritë shoqërore-humanistike;
 - inovacionin, transferimin e njohurive dhe teknologjisë dhe sipërmarrjen;
 - zhvillimin e qëndrueshëm dhe përgjegjësinë shoqërore;
 - zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe administrimin e arsimit të lartë; dhe
 - fusha të tjera me rëndësi për zhvillimin dhe misionin e Universitetit.

Mënyra e realizimit të bashkëpunimit

Neni 14

- (1) Bashkëpunimi ndërkombëtar mund të realizohet në nivel dypalësh dhe shumëpalësh, drejtpërdrejt ose nëpërmjet programeve, projekteve, rrjeteve, asociacioneve ndërkombëtare dhe formave të tjera të lidhjes institucionale.
- (2) Veprimtaritë e bashkëpunimit ndërkombëtar mund të realizohen në nivel të Universitetit, si dhe në kuadër të fakulteteve, instituteve dhe njësive të tjera organizative të Universitetit, në përputhje me kompetencat e tyre.
- (3) Për realizimin e veprimtarive konkrete të bashkëpunimit ndërkombëtar mund të lidhen marrëveshje, protokolle, memorandume, akte mirëkuptimi dhe akte të tjera të veçanta, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.
- (4) Forma, vëllimi dhe mënyra e realizimit të bashkëpunimit konkret përcaktohen në përputhje me natyrën e bashkëpunimit, detyrimet e dakorduara të palëve dhe rregullat e programit ose projektit përkatës.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

V. THEMELIMI I BASHKËPUNIMIT INSTITUCIONAL DHE LIDHJA E MARRËVESHJEVE

Nisma për themelimin e bashkëpunimit institucional

Neni 15

- (1) Nismën për themelimin e bashkëpunimit institucional me një institucion të huaj të arsimit të lartë, institucion shkencor-kërkimor ose institucion tjetër të ngjashëm mund ta ndërmarrin Rektori, Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar, fakulteti, instituti ose njësisia tjetër organizative e Universitetit, si dhe persona të tjerë të autorizuar në përputhje me aktet e Universitetit.
- (2) Nisma mund të burojë edhe nga një propozim ose ofertë e paraqitur nga një institucion apo organizatë e huaj.
- (3) Nisma i paraqitet Njesisë për bashkëpunim ndëruniversitar me universitetet brenda dhe jashtë vendit, e cila e evidenton dhe e shqyrton nga aspekti i përshtatshmërisë formale dhe administrative.

Propozimi për themelimin e bashkëpunimit

Neni 16

- (1) Propozimi për themelimin e bashkëpunimit institucional përgatitet në bazë të nismës dhe duhet të përmbajë së paku:
 - të dhëna për partnerin e huaj të propozuar;
 - arsyetimin e nevojës dhe të bazueshmërisë së bashkëpunimit;
 - objektivin dhe qëllimet e bashkëpunimit të propozuar;
 - fushat dhe format e propozuara të bashkëpunimit;
 - veprimtaritë e propozuara dhe rezultatet e pritshme;
 - kohëzgjatjen e bashkëpunimit;
 - mënyrën e financimit, nëse bashkëpunimi parashikon detyrime financiare; dhe
 - të dhëna të tjera me rëndësi për vlerësimin e propozimit.
- (2) Kur nisma buron nga një fakultet ose institut, propozimi përgatitet në bashkërendim me Njësinë.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Shqyrtimi dhe vlerësimi i propozimit

Neni 17

- (1) Njësia e shqyrton propozimin nga aspekti i përputhshmërisë së tij me ligjin, Statutin, këtë Rregullore dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.
- (2) Gjatë shqyrtimit të propozimit vlerësohen në veçanti:
 - bazueshmëria akademike, shkencore dhe profesionale e bashkëpunimit të propozuar;
 - përputhshmëria me orientimet strategjike dhe interesat e Universitetit;
 - rëndësia dhe besueshmëria e partnerit të propozuar;
 - mundësitë për realizimin e veprimtarive të propozuara;
 - detyrimet financiare dhe detyrimet e tjera që mund të burojnë nga bashkëpunimi; dhe
 - rrethana të tjera me rëndësi për themelimin e bashkëpunimit.
- (3) Njësia mund të kërkojë mendim nga fakulteti, instituti, shërbimi profesional ose një person tjetër kompetent, varësisht nga objekti i bashkëpunimit të propozuar.

Miratimi i bashkëpunimit

Neni 18

- (1) Pas shqyrtimit të propozimit, Njësia ia përcjell atë Prorektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar, së bashku me arsyetimin përkatës dhe, kur është e nevojshme, me mendimet e siguruara.
- (2) Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar e shqyrton propozimin dhe, në përputhje me kompetencat e tij, ia paraqet organit kompetent të Universitetit për marrjen e vendimit, përkatësisht për miratimin e themelimit të bashkëpunimit.
- (3) Vendimin për miratimin e themelimit të bashkëpunimit institucional e merr organi kompetent, në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.

Përgatitja dhe lidhja e marrëveshjes

Neni 19

- (1) Pas miratimit të themelimit të bashkëpunimit, Njësia, në bashkërendim me propozuesin dhe, kur është e nevojshme, me shërbimet profesionale kompetente të Universitetit, përgatit projekt-tekstin e kontratës, memorandumit, marrëveshjes, protokollit ose të një akti tjetër përkatës bashkëpunimi.
- (2) Kontrata, përkatësisht akti tjetër i bashkëpunimit, përmban në veçanti:



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- emërtimin dhe selinë e palëve kontraktuese;
 - objektin dhe qëllimet e bashkëpunimit;
 - fushat dhe format e bashkëpunimit;
 - të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese;
 - mënyrën dhe afatet për realizimin e veprimtarive të parashikuara;
 - mënyrën e financimit dhe shpërndarjen e detyrimeve financiare, kur është e zbatueshme;
 - personat ose njësitë organizative përgjegjëse për bashkërendimin e bashkëpunimit;
 - kohëzgjatjen e kontratës;
 - kushtet dhe procedurën për ndryshimin, vazhdimin dhe përfundimin e kontratës; dhe
 - çështje të tjera me rëndësi për realizimin e bashkëpunimit.
- (3) Para nënshkrimit, projekt-teksti shqyrtohet nga shërbimet profesionale kompetente të Universitetit, kur kjo është e nevojshme.
- (4) Kontratën, memorandum, marrëveshjen, protokollin ose aktin tjetër të bashkëpunimit e nënshkruan Rektori ose një person tjetër i autorizuar, në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.

Realizimi dhe monitorimi i kontratave

Neni 20

- (1) Realizimi i kontratave dhe i akteve të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar bëhet në përputhje me përmbajtjen e tyre, detyrimet e përcaktuara, kornizën kohore dhe planin e veprimtarive.
- (2) Për realizimin e kontratës caktohet një person përgjegjës ose një njësi organizative, kur kjo parashikohet me kontratë ose kur është e nevojshme për zbatimin e saj.
- (3) Njësia e monitoron realizimin administrativ të kontratave dhe siguron bashkërendimin me njësitë organizative kompetente të Universitetit.
- (4) Fakultetet, institutet dhe njësitë e tjera organizative që marrin pjesë në realizimin e kontratës janë të detyruara t'i zbatojnë veprimtaritë e ndërmarra dhe t'i paraqesin Njesisë të dhënat dhe informacionet e nevojshme për monitorimin dhe evidentimin e realizimit.

Ndryshimi, vazhdimi dhe përfundimi i marrëveshjes

Neni 21

- (1) Marrëveshja për bashkëpunim ndërkombëtar mund të ndryshohet ose të plotësohet me pëlqimin e palëve kontraktuese, në përputhje me kushtet dhe procedurën e përcaktuar në marrëveshje.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- (2) Nismën për ndryshimin ose plotësimin e marrëveshjes mund ta ndërmarrin palët kontraktuese, Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar, fakulteti, instituti ose një njësi tjetër organizative që merr pjesë në realizimin e saj.
- (3) Marrëveshja mund të vazhdohet pas skadimit të afatit të saj, nëse ekziston interes për vazhdimin e bashkëpunimit dhe nëse palët kontraktuese arrijnë pajtim për këtë.
- (4) Nisma për vazhdimin e marrëveshjes shqyrtohet para skadimit të afatit të vlefshmërisë së saj, ndërsa procedura për vazhdim zbatohet në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje, përveçse kur në marrëveshje parashikohet ndryshe.
- (5) Marrëveshja përfundon:
 - me skadimin e afatit për të cilin është lidhur;
 - me zgjidhje me marrëveshje të ndërsjellë;
 - me zgjidhje të njëanshme, në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje dhe në dispozitat e zbatueshme; ose
 - në raste të tjera të përcaktuara me ligj ose me marrëveshje.
- (6) Njësia e evidenton ndryshimin, vazhdimin ose përfundimin e marrëveshjes dhe i njofton njësitë organizative përkatëse të Universitetit.

VI. MOBILITETI NDËRKOMBËTAR I STUDENTËVE

Mobiliteti ndërkombëtar i studentëve

Neni 22

- (1) Universiteti e nxit dhe e mbështet pjesëmarrjen e studentëve në mobilitetin ndërkombëtar, si pjesë e procesit të ndërkombëtarizimit dhe avancimit të cilësisë së arsimit të lartë.
- (2) Mobiliteti ndërkombëtar i studentëve realizohet nëpërmjet programeve dhe projekteve të shkëmbimit, marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, marrëveshjeve ndërinstytucionale dhe formave të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar.
- (3) Mobiliteti realizohet në përputhje me ligjin, Statutin, këtë Rregullore, rregullat e programit ose projektit përkatës dhe kushtet e përcaktuara në marrëveshjet me institucionet partnere.

Llojet e mobilitetit studentor

Neni 23

- (1) Mobiliteti ndërkombëtar studentor mund të realizohet si:
 - qëndrim studimor i studentit në një institucion partner të arsimit të lartë jashtë vendit;



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- mobilitet për praktikë ose mobilitet profesional jashtë vendit, kur kjo parashikohet nga programi ose marrëveshja përkatëse;
 - mobilitet afatshkurtër;
 - mobilitet afatgjatë;
 - mobilitet i kombinuar ose virtual, kur parashikohet nga programi përkatës; dhe
 - forma të tjera të mobilitetit studentor, në përputhje me kushtet e programeve dhe marrëveshjeve përkatëse.
- (2) Mobiliteti mund të realizohet në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimeve, në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligj, programin e studimit dhe rregullat e programit përkatës.

Kushtet për pjesëmarrje

Neni 24

- (1) Në mobilitetin ndërkombëtar studentor mund të marrë pjesë studenti që i plotëson kushtet e përcaktuara nga programi, projekti ose marrëveshja përkatëse, si dhe kushtet e përcaktuara me aktet e Universitetit.
- (2) Kushtet për pjesëmarrje mund të lidhen veçanërisht me:
- statusin e studentit;
 - ciklin dhe vitin e studimeve;
 - numrin e kredive të fituara;
 - suksesin akademik;
 - njohjen e gjuhës së nevojshme për realizimin e mobilitetit;
 - plotësimin e kushteve të veçanta të përcaktuara nga institucioni partner ose programi; dhe
 - kushte të tjera që lidhen me formën konkrete të mobilitetit.
- (3) Nëse me rregullat e programit ndërkombëtar ose me marrëveshjen janë përcaktuar kushte të veçanta, zbatohen ato kushte.

Shpallja e thirrjes dhe informimi

Neni 25

- (1) Njësia për bashkëpunim ndëruniversitar me universitetet brenda dhe jashtë vendit i informon studentët për mundësitë e mobilitetit ndërkombëtar dhe i shpall thirrjet për aplikim në mënyrë transparente dhe në kohë.
- (2) Thirrja përmban në veçanti:
- emërtimin dhe përshkrimin e programit ose të veprimtarisë;
 - institucionin ose institucionet partnere;
 - numrin dhe llojin e vendeve në dispozicion;



UNIVERSITETI I TETOVËS УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- periudhën dhe kohëzgjatjen e mobilitetit;
- kushtet dhe kriteret për pjesëmarrje;
- dokumentacionin e nevojshëm;
- afatin dhe mënyrën e paraqitjes së aplikimit;
- informacionet për mbështetjen financiare, nëse është parashikuar; dhe
- informacione të tjera me rëndësi për kandidatët.

Aplikimi dhe përzgjedhja e kandidatëve

Neni 26

- (1) Studenti aplikon në thirrje brenda afatit dhe në mënyrën e përcaktuar në të.
- (2) Aplikimit i bashkëngjitet dokumentacioni i përcaktuar në thirrje dhe në rregullat e programit ose projektit përkatës.
- (3) Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht, objektive dhe transparente.
- (4) Kriteret e përzgjedhjes mund të përfshijnë:
 - suksesin akademik;
 - numrin e kredive të fituara;
 - njohjen e gjuhës së mësimi ose të angazhimit profesional;
 - përputhshmërinë e veprimtarisë së planifikuar me programin e studimit;
 - motivimin dhe rëndësinë e mobilitetit për zhvillimin akademik të studentit; dhe
 - kriteret e tjera të përcaktuara me rregullat e programit ose të thirrjes konkrete.
- (5) Procedura e përzgjedhjes zbatohet në mënyrë që siguron mundësi të barabarta, transparencë dhe mosdiskriminim.

Të drejtat dhe detyrimet e studentit

Neni 27

- (1) Studenti i përzgjedhur për mobilitet ndërkombëtar ka të drejtë:
 - të marrë informacione dhe mbështetje administrative gjatë procedurës;
 - të informohet për kushtet dhe detyrimet që lidhen me mobilitetin;
 - t'i ushtrojë të drejtat në përputhje me marrëveshjen, programin dhe aktet e Universitetit;
 - t'i njihen rezultatet akademike të arritura në kuadër të mobilitetit të miratuar, në përputhje me rregullat e njohjes; dhe
 - të marrë dokumentacionin përkatës për mobilitetin e realizuar.
- (2) Studenti është i detyruar:



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- t'i respektojë rregullat e Universitetit dhe të institucionit partner;
- t'i përmbushë detyrimet akademike dhe detyrimet e tjera të ndërmarra në kuadër të mobilitetit;
- ta realizojë mobilitetin në përputhje me planin e miratuar;
- ta njoftojë Universitetin në kohë për rrethanat që mund të ndikojnë në realizimin e mobilitetit;
- ta dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm para, gjatë dhe pas përfundimit të mobilitetit; dhe
- të veprojë në përputhje me rregullat e programit përkatës dhe marrëveshjen e mobilitetit.

Njohja akademike e mobilitetit

Neni 28

- (1) Studentit i njihet periudha e studimit ose veprimtaria tjetër akademike e realizuar jashtë vendit, nëse mobiliteti është miratuar paraprakisht dhe veprimtaritë janë realizuar në përputhje me planin e miratuar dhe kushtet e programit ose marrëveshjes përkatëse.
- (2) Para fillimit të mobilitetit përcaktohet plani i studimit ose veprimtaritë e tjera që studenti do t'i realizojë jashtë vendit, në përputhje me programin e studimit dhe rregullat e mobilitetit.
- (3) Njohja e kredive të fituara dhe e rezultateve akademike bëhet në përputhje me dispozitat në fuqi, programin e studimit, rregullat e Universitetit dhe kushtet e programit përkatës ndërkombëtar.
- (4) Studenti nuk mund të vihet në pozitë të pafavorshme lidhur me statusin e tij akademik për shkak të pjesëmarrjes në një mobilitet ndërkombëtar të miratuar.

Mbështetja financiare

Neni 29

- (1) Studentët që marrin pjesë në mobilitet ndërkombëtar mund të përfitojnë mbështetje financiare në përputhje me rregullat dhe mjetet në dispozicion të programit ndërkombëtar përkatës, projektit, Universitetit ose një burimi tjetër financimi.
- (2) Kushtet, shuma, mënyra e pagesës dhe çështjet e tjera që lidhen me mbështetjen financiare përcaktohen në përputhje me rregullat e programit ose projektit përkatës dhe aktet e zbatueshme të Universitetit.
- (3) Pjesëmarrja në mobilitet pa mbështetje financiare nuk e përjashton studentin nga mundësia e pjesëmarrjes në program, nëse kjo lejohet me rregullat e programit përkatës.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Përfundimi dhe raportimi për mobilitetin

Neni 30

- (1) Pas përfundimit të mobilitetit, studenti është i detyruar ta dorëzojë dokumentacionin e përcaktuar me rregullat e programit ose projektit dhe me aktet e Universitetit.
- (2) Njësia e evidenton mobilitetin e realizuar dhe i përpunon të dhënat e nevojshme për monitorimin dhe raportimin lidhur me mobilitetin ndërkombëtar studentor.
- (3) Studentit mund t'i kërkohej t'i ndajë përvojat dhe praktikat e mira nga mobiliteti i realizuar me studentët e tjerë dhe me Universitetin.
- (4) Mënyra dhe afatet për dorëzimin e dokumentacionit dhe për raportimin përcaktohen me rregullat e programit përkatës ose me një procedurë të veçantë të Universitetit.

VII. MOBILITETI NDËRKOMBËTAR I PERSONELIT AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV

Mobiliteti ndërkombëtar i personelit akademik dhe administrativ

Neni 31

- (1) Universiteti e nxit dhe e mbështet mobilitetin ndërkombëtar të personelit akademik dhe administrativ, me qëllim avancimin e punës mësimore, shkencore-kërkimore dhe profesionale, zhvillimin e kompetencave profesionale dhe shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe praktikave të mira.
- (2) Mobiliteti ndërkombëtar realizohet nëpërmjet programeve dhe projekteve ndërkombëtare, marrëveshjeve me institucionet partnere, marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe formave të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar.
- (3) Mobiliteti realizohet në përputhje me ligjin, Statutin, këtë Rregullore, aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit dhe rregullat e programit, projektit ose marrëveshjes përkatëse.

Llojet e mobilitetit

Neni 32

- (1) Mobiliteti ndërkombëtar i personelit akademik mund të realizohet veçanërisht nëpërmjet:
 - mbajtjes së mësimit ose realizimit të veprimtarive të tjera arsimore në një institucion partner;
 - qëndrimit shkencor-kërkimor;



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- pjesëmarrjes në veprimtari shkencore dhe profesionale;
 - pjesëmarrjes në konferenca, kongrese, simpoziume dhe ngjarje të tjera akademike;
 - shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira;
 - zhvillimit profesional dhe trajnimeve;
 - përgatitjes dhe realizimit të veprimtarive të përbashkëta arsimore dhe shkencore-kërkimore; dhe
 - formave të tjera të mobilitetit, në përputhje me rregullat e programit ose marrëveshjes përkatëse.
- (2) Mobiliteti ndërkombëtar i personelit administrativ mund të realizohet veçanërisht nëpërmjet:
- trajnimeve profesionale;
 - shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira;
 - formave të ndryshme të të nxënit praktik;
 - pjesëmarrjes në takime pune dhe në veprimtari që lidhen me programe dhe projekte ndërkombëtare;
 - zhvillimit të kompetencave profesionale; dhe
 - formave të tjera të mobilitetit profesional, në përputhje me rregullat e programit ose marrëveshjes përkatëse.

Kushtet për pjesëmarrje

Neni 33

- (1) Në mobilitetin ndërkombëtar mund të marrë pjesë personeli akademik ose administrativ që i plotëson kushtet e përcaktuara nga programi, projekti ose marrëveshja përkatëse dhe kushtet e përcaktuara me aktet e Universitetit.
- (2) Kushtet për pjesëmarrje mund të lidhen veçanërisht me:
- statusin e punësimit të kandidatit;
 - vendin e punës dhe fushën e angazhimit;
 - rëndësinë e mobilitetit të planifikuar për punën dhe zhvillimin profesional;
 - njohjen e gjuhës së nevojshme për realizimin e mobilitetit;
 - plotësimin e kushteve të institucionit partner ose të programit; dhe
 - kushte të tjera që lidhen me mobilitetin konkret.

Thirrja dhe aplikimi

Neni 34

- (1) Njësia për bashkëpunim ndëruniversitar me universitetet brenda dhe jashtë vendit i informon të punësuarit për mundësitë e mobilitetit ndërkombëtar dhe i shpall thirrjet për aplikim.
- (2) Thirrja përmban në veçanti:



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- emërtimin dhe përshkrimin e programit ose të veprimtarisë;
 - institucionin partner;
 - llojin dhe kohëzgjatjen e mobilitetit;
 - kushtet dhe kriteret për pjesëmarrje;
 - dokumentacionin e nevojshëm;
 - afatin dhe mënyrën e aplikimit;
 - informacionet për mbështetjen financiare, nëse është parashikuar; dhe
 - informacione të tjera me rëndësi për kandidatët.
- (3) Aplikimi bëhet në mënyrën dhe brenda afatit të përcaktuar në thirrje dhe në rregullat e programit përkatës.

Përzgjedhja e kandidatëve

Neni 35

- (1) Përzgjedhja e kandidatëve për mobilitet ndërkombëtar bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht, objektive dhe transparente.
- (2) Gjatë përzgjedhjes merren parasysh veçanërisht:
- rëndësia e mobilitetit për punën dhe zhvillimin profesional;
 - veprimtaritë akademike, shkencore-kërkimore ose profesionale të kandidatit;
 - cilësia dhe realizueshmëria e programit të propozuar të mobilitetit;
 - kontributi i mobilitetit në zhvillimin e Universitetit;
 - njohja e gjuhës, kur ajo është kusht për realizimin e veprimtarisë; dhe
 - kriterë të tjera të përcaktuara me rregullat e programit ose të thirrjes konkrete.
- (3) Gjatë përzgjedhjes sigurohen mundësi të barabarta, transparencë dhe mosdiskriminim.

Miratimi dhe realizimi i mobilitetit

Neni 36

- (1) Mobiliteti ndërkombëtar i personelit akademik dhe administrativ miratohet në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.
- (2) Para fillimit të mobilitetit përcaktohet plani ose programi i mobilitetit, në përputhje me rregullat e programit, projektit ose marrëveshjes përkatëse.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- (3) Gjatë mobilitetit, pjesëmarrësi është i detyruar t'i përmbushë detyrimet e përcaktuara në planin e miratuar, programin e mobilitetit dhe rregullat e institucionit partner.
- (4) Mobiliteti nuk duhet të ndikojë në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga marrëdhënia e punës, përveç në pjesën e përcaktuar me ligj, me akt të Universitetit ose me marrëveshjen përkatëse.

Të drejtat dhe detyrimet, si dhe raportimi pas përfundimit të mobilitetit

Neni 37

- (1) Pjesëmarrësi në mobilitetin ndërkombëtar ka të drejtë:
 - të marrë informacione dhe mbështetje administrative gjatë procedurës;
 - të informohet për kushtet dhe detyrimet që lidhen me mobilitetin;
 - të përfitojë mbështetje financiare, nëse ajo është parashikuar;
 - të pajiset me vërtetim ose dokumentacion tjetër përkatës për mobilitetin e realizuar; dhe
 - t'i shfrytëzojë njohuritë dhe përvojat e fituara në punën e mëtejshme në Universitet.
- (2) Pjesëmarrësi është i detyruar:
 - t'i respektojë rregullat e Universitetit dhe të institucionit partner;
 - ta realizojë programin e miratuar të mobilitetit;
 - ta njoftojë me kohë Universitetin për rrethanat që mund të ndikojnë në realizimin e mobilitetit;
 - ta dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm para, gjatë dhe pas përfundimit të mobilitetit; dhe
 - pas përfundimit të mobilitetit, të dorëzojë raport ose dokumentacion tjetër, në përputhje me rregullat e programit ose të Universitetit.
- (3) Njësia e evidenton mobilitetin e realizuar dhe i përpunon të dhënat e nevojshme për monitorim dhe raportim.
- (4) Universiteti mund të organizojë veprimtari për shkëmbimin, me të punësuarit dhe njësitë e tjera organizative, të njohurive dhe përvojave të fituara nga mobilitetet e realizuara.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

VIII. PRANIMI I STUDENTËVE TË HUAJ DHE I KUADRIT MYSAFIR

Pranimi i studentëve të huaj dhe i kuadrit mysafir

Neni 38

- (1) Universiteti nxit dhe zhvillon pranimin e studentëve të huaj, profesorëve mysafirë, hulumtuesve, profesionistëve dhe përfaqësuesve të tjerë të institucioneve partnere dhe institucioneve, shkencore-kërkimore dhe të ngjashme të arsimit të lartë.
- (2) Pranimi realizohet në kuadër të programeve dhe projekteve ndërkombëtare, marrëveshjeve të bashkëpunimit, programeve të mobilitetit dhe shkëmbimit, si dhe mbi bazën e formave të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar.
- (3) Pranimi zbatohet në përputhje me ligjin, Statutin, këtë Rregullore, aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit dhe rregullat e programit ose marrëveshjes përkatëse.

Pranimi i studentëve të huaj

Neni 39

- (1) Studentët e huaj mund të realizojnë qëndrim studimor në Universitet në bazë të një programi ndërkombëtar të mobilitetit, të një marrëveshjeje për bashkëpunim ndërinstitutional ose të një baze tjetër përkatëse.
- (2) Pranimi i studentëve të huaj bëhet në përputhje me kushtet e përcaktuara nga programi përkatës, marrëveshja me institucionin partner, si dhe nga dispozitat dhe aktet e Universitetit.
- (3) Studentit të huaj, në kuadër të mundësive të Universitetit, i sigurohen informacione dhe mbështetje administrative lidhur me:
 - programet e studimit dhe lëndët që mund t'i zgjedhë;
 - kushtet për realizimin e qëndrimit studimor;
 - të drejtat dhe detyrimet gjatë qëndrimit;
 - procedurat administrative që lidhen me qëndrimin; dhe
 - çështje të tjera me rëndësi për realizimin e suksesshëm të qëndrimit studimor.
- (4) Studenti i huaj i gëzon të drejtat dhe i përmbush detyrimet në përputhje me ligjin, aktet e Universitetit, rregullat e programit dhe marrëveshjen në bazë të së cilës është pranuar.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Pranimi i profesorëve mysafirë dhe i hulumtuesve

Neni 40

- (1) Universiteti mund të pranojë profesorë mysafirë, hulumtues dhe persona të tjerë akademikë ose profesionistë nga jashtë vendit, me qëllim të:
 - mbajtjes së mësimit dhe realizimit të veprimtarive të tjera arsimore;
 - realizimit të veprimtarive shkencore-kërkimore;
 - pjesëmarrjes në projekte shkencore dhe profesionale;
 - pjesëmarrjes në konferenca, simpoziume, seminare dhe ngjarje të tjera akademike;
 - shkëmbimit të njohurive, përvojave dhe praktikave të mira;
 - zhvillimit të veprimtarive të përbashkëta studimore dhe kërkimore-shkencore; dhe
 - veprimtarive të tjera me interes të përbashkët akademik dhe profesional.
- (2) Pranimi i kuadrit mysafir bëhet në bazë të ftesës, marrëveshjes, programit ose një akti tjetër bashkëpunimi, në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.
- (3) Para pranimit përcaktohen qëllimi, kohëzgjatja dhe lloji i veprimtarive, si dhe, kur është e zbatueshme, të drejtat dhe detyrimet e kuadrit mysafir.

Nisja dhe miratimi i pranimit

Neni 41

- (1) Nismën për pranimin e një studenti të huaj ose të kuadrit mysafir mund ta paraqesë fakulteti, instituti, një njësi tjetër organizative, Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar ose një person tjetër i autorizuar.
- (2) Nisma i dorëzohet Njesisë për bashkëpunim ndëruniversitar me universitetet brenda dhe jashtë vendit, e cila siguron mbështetje administrative dhe koordinuese gjatë procedurës.
- (3) Pranimi miratohet nga organi kompetent ose personi i autorizuar, në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.
- (4) Njësia mban evidencë përkatëse për pranimin e studentëve të huaj dhe të kuadrit mysafir.

Mbështetja e studentëve të huaj dhe e kuadrit mysafir

Neni 42

- (1) Universiteti, në kuadër të mundësive dhe kompetencave të tij, siguron mbështetje administrative dhe institucionale për integrimin e suksesshëm të studentëve të huaj dhe të kuadrit mysafir në mjedisin akademik.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- (2) Mbështetja mund të përfshijë:
- sigurimin e informacioneve për procesin akademik dhe kushtet e qëndrimit;
 - ndihmë gjatë procedurave administrative që lidhen me realizimin e qëndrimit;
 - udhëzimin të shërbimet kompetente dhe njësitë organizative;
 - sigurimin e informacioneve për veprimtaritë akademike dhe veprimtaritë e tjera të Universitetit; dhe
 - forma të tjera mbështetjeje, në përputhje me mundësitë dhe nevojat.
- (3) Fakultetet, institutet dhe njësitë e tjera organizative janë të detyruara që, në kuadër të kompetencave të tyre, të sigurojnë kushte për realizimin pa pengesa të veprimtarive akademike dhe profesionale të studentëve të huaj dhe të kuadrit mysafir.

Të drejtat dhe detyrimet e studentëve të huaj dhe të kuadrit mysafir

Neni 43

- (1) Studentët e huaj dhe kuadri mysafir kanë të drejtë të informohen për kushtet, rregullat dhe detyrimet që lidhen me qëndrimin e tyre dhe me veprimtaritë në Universitet.
- (2) Studentët e huaj dhe kuadri mysafir janë të detyruar t'i respektojnë ligjet e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Statutin, aktet e përgjithshme të Universitetit, rregullat e njësisë organizative në të cilën i realizojnë veprimtaritë, si dhe kushtet e përcaktuara nga programi, marrëveshja ose akti tjetër në bazë të të cilit është realizuar pranimi.
- (3) Mënyra e rregullimit të qëndrimit, angazhimit, kompensimeve dhe të drejtave e detyrimeve të tjera të kuadrit mysafir përcaktohet në përputhje me dispozitat e zbatueshme, aktet e Universitetit dhe marrëveshjen ose aktin përkatës të angazhimit.
- (4) Pas përfundimit të qëndrimit, kur kjo parashikohet me programin ose marrëveshjen, studenti i huaj ose kuadri mysafir, dorëzon dokumentacionin përkatës për veprimtaritë e realizuara.

IX. PROJEKTET DHE PROGRAMET NDËRKOMBËTARE

Pjesëmarrja në programe dhe projekte ndërkombëtare

Neni 44

- (1) Universiteti merr pjesë në programe dhe projekte evropiane e ndërkombëtare arsimore, shkencore-kërkimore, profesionale, zhvillimore dhe të tjera, të cilat kanë rëndësi për përmbushjen e misionit dhe të qëllimeve të tij strategjike.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- (2) Pjesëmarrja në programe dhe projekte ndërkombëtare mund të realizohet në cilësinë e:
- koordinatorit ose bartësit të programit apo projektit;
 - institucionit partner;
 - anëtarit të një konsorciumi ose të një forme tjetër partneriteti;
 - institucionit pritës ose dërgues në veprimtaritë e mobilitetit dhe shkëmbimit; dhe
 - formave të tjera të përcaktuara nga rregullat e programit ose projektit përkatës.
- (3) Universiteti mund të marrë pjesë në programe ekzistuese dhe të ardhshme evropiane e ndërkombëtare, duke përfshirë Erasmus+, CEEPUS dhe Mevlana, si dhe në programe të tjera, në përputhje me qëllimin, kushtet dhe mundësitë e disponueshme.

Qëllimet e pjesëmarrjes në programe dhe projekte ndërkombëtare

Neni 45

- (1) Pjesëmarrja e Universitetit në programe dhe projekte ndërkombëtare ka për qëllim:
- ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe të veprimtarisë shkencore-kërkimore;
 - zhvillimin e partneriteteve akademike dhe institucionale ndërkombëtare;
 - avancimin e mobilitetit dhe të shkëmbimit të studentëve dhe të të punësuarve;
 - zhvillimin dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta arsimore dhe kërkimore - shkencore;
 - avancimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale;
 - shkëmbimin dhe zbatimin e njohurive, përvojave dhe praktikave të mira;
 - sigurimin e mundësive shtesë për zhvillim dhe inovacion në arsim dhe shkencë; dhe
 - rritjen e dukshmërisë dhe ndërlidhjes ndërkombëtare të Universitetit.

Identifikimi dhe nisja e mundësive për projekte

Neni 46

- (1) Njësia për bashkëpunim ndëruniversitar me universitetet brenda dhe jashtë vendit i monitoron mundësitë për pjesëmarrjen e Universitetit në programe dhe projekte evropiane e ndërkombëtare dhe i informon organet dhe njësitë organizative përkatëse.
- (2) Nismën për pjesëmarrje në një program ose projekt ndërkombëtar mund ta ndërmarrë rektori, Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar, fakulteti, instituti, një njësi tjetër organizative ose një person tjetër i autorizuar.
- (3) Nisma duhet të përmbajë informacionet bazë për programin ose projektin, rolin e propozuar të Universitetit, qëllimet dhe rezultatet e pritshme, partnerët, afatin kohor dhe, kur është e zbatueshme, detyrimet financiare dhe detyrimet e tjera.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Përgatitja dhe dorëzimi i propozim-projekteve

Neni 47

- (1) Propozim-projekti përgatitet në koordinim me njësitë përkatëse organizative të Universitetit dhe në përputhje me rregullat dhe kushtet e programit ose thirrjes përkatëse.
- (2) Për çdo propozim-projekt caktohet një person përgjegjës ose një ekip projekti, në përputhje me natyrën dhe vëllimin e projektit.
- (3) Gjatë përgatitjes së propozim-projektit, vëmendje e veçantë i kushtohet:
 - përputhshmërisë së projektit me misionin, përcaktimet strategjike dhe prioritetet e Universitetit;
 - rëndësisë dhe cilësisë së veprimtarive të propozuara;
 - kapacitetit të Universitetit për realizimin e veprimtarive të parashikuara;
 - detyrimeve që burojnë nga pjesëmarrja në projekt;
 - qëndrueshmërisë dhe rezultateve të pritshme të projektit; dhe
 - kushteve financiare dhe kushteve të tjera të përcaktuara në thirrje.
- (4) Propozim-projektet dorëzohen nga personi i autorizuar dhe në mënyrën e përcaktuar nga rregullat e programit ose projektit përkatës.

Miratimi dhe realizimi i projekteve ndërkombëtare

Neni 48

- (1) Pjesëmarrja e Universitetit në një projekt ndërkombëtar miratohet në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.
- (2) Pas miratimit të pjesëmarrjes, për realizimin e projektit caktohen personat përgjegjës, njësitë organizative dhe, kur është e nevojshme, ekipi i projektit.
- (3) Projekti realizohet në përputhje me propozim-projektin e miratuar, marrëveshjen e grantit, marrëveshjen e konsorciumit dhe aktet e tjera përkatëse, si dhe me rregullat e programit përkatës.
- (4) Personi përgjegjës ose ekipi i projektit janë të detyruar të sigurojnë zbatimin në kohë të veprimtarive dhe përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Koordinimi dhe monitorimi i projekteve

Neni 49

- (1) Njësia siguron mbështetje administrative dhe koordinuese për realizimin e projekteve ndërkombëtare, në kuadër të kompetencave të saj.
- (2) Për çdo projekt mbahet dokumentacioni përkatës, në përputhje me rregullat e programit dhe të Universitetit.
- (3) Personi përgjegjës ose ekipi i projektit i dorëzon Njesisë të dhënat dhe informacionet e nevojshme për monitorimin e realizimit dhe për përmbushjen e detyrimeve të raportimit.
- (4) Për projektet monitorohen veçanërisht:
 - realizimi i veprimtarive të planifikuara;
 - respektimi i afatit kohor;
 - arritja e rezultateve të planifikuara;
 - përmbushja e detyrimeve financiare dhe detyrimeve të tjera, në bashkëpunim me shërbimet kompetente; dhe
 - përmbushja e detyrimeve të raportimit ndaj donatorit, programit ose partnerëve.

Raportimi dhe rezultatet e projekteve

Neni 50

- (1) Pas përfundimit të projektit ndërkombëtar përgatitet raporti përfundimtar, në përputhje me rregullat e programit ose projektit përkatës.
- (2) Rezultatet e projekteve ndërkombëtare të realizuara evidentohen dhe, kur është e përshtatshme, u paraqiten organeve dhe njësive organizative përkatëse të Universitetit.
- (3) Universiteti nxit shkëmbimin me komunitetin akademik dhe profesional të rezultateve, njohurive dhe praktikave të mira të fituara përmes projekteve ndërkombëtare.
- (4) Përvojat dhe rezultatet e projekteve të realizuara shfrytëzohen për avancimin e veprimtarive të ardhshme të Universitetit në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

X. ANËTARËSIMI NË ASOCIACIONE, RRJETE DHE ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE

Anëtarësimi në asociacione, rrjete dhe organizata ndërkombëtare

Neni 51

- (1) Universiteti mund të anëtarësohet dhe të marrë pjesë në punën e asociacioneve, rrjeteve, organizatave, unioneve dhe nismave ndërkombëtare e evropiane, si dhe në forma të tjera të ndërlidhjes institucionale me rëndësi për arsimin e lartë, shkencën, hulumtimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.
- (2) Anëtarësimi ka për qëllim:



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- avancimin e pozitës dhe të dukshmërisë ndërkombëtare të Universitetit;
- krijimin dhe zhvillimin e partneriteteve me institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet shkencore-kërkimore;
- shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe praktikave të mira;
- pjesëmarrjen në veprimtari akademike dhe shkencore-kërkimore ndërkombëtare;
- pjesëmarrjen në nisma dhe procese ndërkombëtare me rëndësi për arsimin e lartë dhe shkencën;
- përfaqësimin dhe afirmimin e interesave dhe prioritetëve të Universitetit në hapësirën akademike ndërkombëtare; dhe
- qëllime të tjera me rëndësi për zhvillimin dhe ndërkombëtarizimin e Universitetit.

Format e anëtarësimit dhe të pjesëmarrjes

Neni 52

- (1) Universiteti mund të marrë pjesë në asociacione, rrjete dhe organizata ndërkombëtare në cilësinë e:
 - anëtarit të plotë ose të asociuar;
 - partnerit ose anëtarit institucional;
 - nënshkruesit të deklaratave, kartave dhe nismave ndërkombëtare;
 - anëtarit ose pjesëmarrësit në grupe pune, komisione, këshilla dhe organe të tjera;
 - pjesëmarrësit në programe, projekte dhe veprimtari të përbashkëta; dhe
 - formave të tjera të përcaktuara me aktet e organizatës ose nismës përkatëse.
- (2) Universiteti mund të jetë anëtar ose pjesëmarrës në asociacione, rrjete dhe organizata evropiane e ndërkombëtare, duke përfshirë European University Association (EUA), Magna Charta Universitatum/Magna Charta Observatory, Eurasian Universities Union (EURAS), Balkan Universities Association (BUA), si dhe organizata dhe rrjete të tjera me rëndësi për veprimtarinë e tij.
- (3) Lista nga paragrafi (2) i këtij neni nuk është kufizuese dhe mund të plotësohet me anëtarësime të reja, në përputhje me interesat dhe përcaktimet strategjike të Universitetit.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Nisja dhe miratimi i anëtarësimit

Neni 53

- (1) Nismën për anëtarësim ose pjesëmarrje në një asociacion, rrjet ose organizatë ndërkombëtare mund ta ndërmarrë Rektori, Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar, fakulteti, instituti, një njësi tjetër organizative ose një person tjetër i autorizuar.
- (2) Nisma duhet të përmbajë arsyetimin për rëndësinë e anëtarësimit të propozuar, informacionet bazë për organizatën, kushtet e anëtarësimit, të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga anëtarësimi dhe, kur është e zbatueshme, detyrimet financiare.
- (3) Njësia për bashkëpunim ndëruniversitar me universitetet brenda dhe jashtë vendit e shqyrton nismën dhe përgatit informacionet përkatëse dhe propozimin për veprime të mëtejshme.
- (4) Vendimin për anëtarësim ose pjesëmarrje e merr organi kompetent, në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.

Koordinimi dhe pjesëmarrja në punë

Neni 54

- (1) Për çdo anëtarësim ose pjesëmarrje të rëndësishme të Universitetit mund të caktohet një person përgjegjës ose një njësi organizative për koordinimin e veprimtarive dhe të komunikimit me organizatën, asociacionin ose rrjetin përkatës ndërkombëtar.
- (2) Njësia e monitoron komunikimin dhe veprimtaritë që lidhen me anëtarësimet institucionale dhe, në bashkëpunim me njësitë organizative përkatëse, siguron mbështetje administrative dhe koordinuese.
- (3) Përfaqësuesit e Universitetit në asociacionet, rrjetet dhe organizatat ndërkombëtare veprojnë në kuadër të autorizimit të dhënë dhe i përfaqësojnë interesat e Universitetit në përputhje me përcaktimet strategjike dhe aktet e tij.
- (4) Për veprimtaritë dhe përfitimet nga anëtarësimi mund të përgatiten informacione ose raporte periodike, në përputhje me nevojat e Universitetit.

Detyrimet financiare dhe përfundimi i anëtarësimit

Neni 55

- (1) Detyrimet financiare që burojnë nga anëtarësimi në asociacione, rrjete dhe organizata ndërkombëtare përmbushen në përputhje me vendimet e organeve kompetente të Universitetit, mjetet e disponueshme, dispozitat në fuqi dhe aktet e Universitetit.
- (2) Gjatë vendimmarrjes për vazhdimin e anëtarësimit merren parasysh përfitimet nga anëtarësimi, niveli i veprimtarisë dhe i pjesëmarrjes së Universitetit, rezultatet e arritura, si dhe detyrimet financiare dhe detyrimet e tjera.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- (3) Universiteti mund ta ndërpresë anëtarësimin ose pjesëmarrjen në një asociacion, rrjet ose organizatë ndërkombëtare, në përputhje me kushtet e përcaktuara në aktet e saj dhe me vendim të organit kompetent të Universitetit.
- (4) Njësia e evidenton anëtarësimin, vazhdimin ose përfundimin e tij dhe siguron përditësimin e të dhënave për anëtarësimet institucionale.

XI. FINANCIMI

Burimet e financimit

Neni 56

- (1) Veprimtaritë nga fusha e bashkëpunimit ndërkombëtar financohen nga:
 - mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me destinimin dhe mjetet e disponueshme;
 - të hyrat e Universitetit;
 - mjetet e siguruar përmes programeve dhe projekteve evropiane dhe ndërkombëtare;
 - grantet, donacionet dhe mjetet e tjera nga burime vendore dhe të huaja;
 - mjetet e siguruar nga institucionet partnere;
 - mjetet nga organizatat ndërkombëtare, fondacionet dhe subjektet e tjera; dhe
 - burime të tjera në përputhje me ligjin dhe aktet e Universitetit.
- (2) Mjetet nga paragrafi (1) i këtij neni përdoren në mënyrë të dedikuar dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara nga burimi i financimit, kontrata, programi ose projekti dhe dispozitat në fuqi.

Financimi i veprimtarive të bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 57

- (1) Mjetet për bashkëpunim ndërkombëtar mund të përdoren për financimin ose bashkëfinancimin e:
 - mobilitetit ndërkombëtar të studentëve dhe të punësuarve;
 - pranimi dhe qëndrimin të studentëve të huaj dhe kuadrit mysafir;
 - pjesëmarrjes dhe organizimit të konferencave, kongreseve, simpoziumeve, seminareve dhe veprimtarive të tjera akademike dhe profesionale ndërkombëtare;
 - realizimit të projekteve dhe programeve ndërkombëtare;



UNIVERSITETI I TETOVËS

УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- anëtarësive në asociacione, rrjete dhe organizata ndërkombëtare;
- shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve që lidhen me qëndrimin jashtë vendit, në përputhje me rregullat e zbatueshme;
- përkthimit, lekturimit, botimeve dhe veprimtarive të tjera që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar;
- veprimtarive për promovimin dhe avancimin e dukshmërisë ndërkombëtare të Universitetit; dhe
- shpenzimeve të tjera të arsyeshme që lidhen me realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Bashkëfinancimi

Neni 58

- (1) Kur rregullat e programit ose projektit ndërkombëtar parashikojnë kontribut vetjak ose bashkëfinancim, Universiteti mund të sigurojë mjete për mbulimin e pjesës së përcaktuar të shpenzimeve, në përputhje me mundësitë e veta financiare dhe vendimet e organeve kompetente.
- (2) Bashkëfinancimi mund të sigurohet nga mjetet vetjake të Universitetit, mjetet e njësive organizative, mjetet e projekteve ose burime të tjera të lejuara financimi.
- (3) Për çdo detyrim për bashkëfinancim përcaktohen burimi dhe mënyra e sigurimit të mjeteve, përpara marrjes përsipër të detyrimit financiar.

Detyrimet financiare dhe përgjegjësia

Neni 59

- (1) Detyrimet financiare që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar merren përsipër dhe realizohen në përputhje me ligjin, dispozitat financiare dhe aktet e përgjithshme të Universitetit.
- (2) Për çdo veprimtari ndërkombëtare që krijon detyrime financiare sigurohet dokumentacioni përkatës për arsyeshmërinë, miratimin dhe realizimin e shpenzimeve.
- (3) Në projektet ndërkombëtare, mjetet përdoren në përputhje me buxhetin e miratuar, kontratën e financimit, rregullat e donatorit dhe aktet e tjera përkatëse.
- (4) Personi përgjegjës për projektin ose veprimtarinë është i detyruar të bashkëpunojë me shërbimet kompetente financiare dhe profesionale të Universitetit dhe të sigurojë dorëzimin në kohë të dokumentacionit të nevojshëm.
- (5) Kontrolli financiar, evidentimi kontabël dhe raportimi kryhen në përputhje me dispozitat në fuqi dhe aktet e brendshme të Universitetit.

Transparenca financiare dhe llogaridhënia

Neni 60

- (1) Financimi i veprimtarive të bashkëpunimit ndërkombëtar zbatohet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, ekonomizimit, efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- (2) Universiteti mban dokumentacionin përkatës financiar dhe administrativ për veprimtaritë e realizuara dhe siguron gjurmueshmërinë e mjeteve, në përputhje me dispozitat në fuqi dhe rregullat e programeve dhe projekteve përkatëse.
- (3) Përdoruesit e mjeteve janë të detyruar t'i përdorin ato sipas destinimit dhe ta dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm për arsyetimin e shpenzimeve të kryera, brenda afateve dhe në mënyrën e përcaktuar me dispozitat, kontratat dhe aktet e zbatueshme të Universitetit.

XII. EVIDENTIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Evidentimi i bashkëpunimit ndërkombëtar

Neni 61

- (1) Njësia për bashkëpunim ndëruniversitar me universitetet brenda dhe jashtë vendit mban evidencë të centralizuar për veprimtaritë nga fusha e bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit.
- (2) Evidenca përfshin në veçanti të dhëna për:
 - kontratat ndërkombëtare, memorandumet, marrëveshjet, protokollet dhe aktet e tjera të lidhura për bashkëpunim;
 - institucionet partnere të arsimit të lartë, institucionet shkencore-kërkimore dhe institucionet e tjera;
 - programet dhe projektet ndërkombëtare në të cilat merr pjesë Universiteti;
 - mobilitetin ndërkombëtar të studentëve;
 - mobilitetin ndërkombëtar të kuadrit akademik dhe administrativ;
 - studentët e huaj të pranuar dhe kuadrin mysafir;
 - anëtarësimet e Universitetit në asociacione, rrjete dhe organizata ndërkombëtare;
 - veprimtaritë dhe ngjarjet ndërkombëtare të realizuara, si dhe format e tjera të bashkëpunimit;
 - mjetet financiare dhe burimet e financimit që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar, për pjesën për të cilën Njësia disponon të dhëna; dhe
 - të dhëna të tjera me rëndësi për monitorimin dhe avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.
- (3) Evidenca mbahet në formë elektronike dhe/ose në një formë tjetër të përshtatshme dhe përditësohet vazhdimisht.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Dorëzimi i të dhënave

Neni 62

- (1) Fakultetet, institutet dhe njësitë e tjera organizative të Universitetit janë të detyruara t'i dorëzojnë Njësisë të dhëna dhe dokumentacion për veprimtaritë e realizuara të bashkëpunimit ndërkombëtar në kuadër të kompetencës së tyre.
- (2) Të dhënat dorëzohen brenda afatit dhe në mënyrën e përcaktuar me procedurë të brendshme, formular ose kërkesë të Njësisë.
- (3) Njësia mund të kërkojë të dhëna dhe dokumentacion shtesë, kur kjo është e nevojshme për mbajtjen e plotë dhe të saktë të evidencës, përgatitjen e raporteve ose përmbushjen e detyrimeve të Universitetit ndaj institucioneve, programeve ose organizatave të jashtme.
- (4) Njësitë organizative janë përgjegjëse për saktësinë dhe dorëzimin në kohë të të dhënave.

Monitorimi dhe vlerësimi

Neni 63

- (1) Universiteti e monitoron vazhdimisht realizimin e veprimtarive të bashkëpunimit ndërkombëtar, me qëllim vlerësimin e suksesit, efekteve dhe kontributit të tyre në arritjen e objektivave strategjike të Universitetit.
- (2) Monitorimi përfshin në veçanti:
 - numrin dhe realizimin e kontratave dhe partneriteteve ndërkombëtare;
 - vëllimin dhe rezultatet e mobilitetit të studentëve dhe të kuadrit;
 - pjesëmarrjen dhe rezultatet nga programet dhe projektet ndërkombëtare;
 - veprimtaritë dhe përfitimet nga anëtarësimi në asociacione dhe rrjete ndërkombëtare;
 - numrin dhe kategorinë e studentëve të huaj të pranuar dhe të kuadrit mysafir;
 - veprimtaritë e realizuara akademike, shkencore-kërkimore dhe profesionale;
 - rezultatet dhe përfitimet e arritura për Universitetin; dhe
 - tregues të tjerë relevantë për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.
- (3) Për nevojat e monitorimit dhe vlerësimit mund të përdoren tregues sasiore dhe cilësore.

Raportimi

Neni 64

- (1) Njësia përgatit raporte periodike ose vjetore për realizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të Universitetit.
- (2) Raporti përmban në veçanti të dhëna për:
 - kontratat dhe partneritetet ndërkombëtare të realizuara;
 - mobilitetin e studentëve dhe të kuadrit;
 - programet dhe projektet ndërkombëtare;
 - anëtarësimet në asociacione, rrjete dhe organizata ndërkombëtare;



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- pranimin e studentëve të huaj dhe të kuadrit mysafir;
 - veprimtaritë e realizuara dhe rezultatet e arritura;
 - aspektet financiare, në bashkëpunim me shërbimet kompetente;
 - sfidat e konstatuara dhe nevojat për avancim; dhe
 - të dhëna të tjera me rëndësi për bashkëpunimin ndërkombëtar.
- (3) Raporti u dorëzohet organeve kompetente të Universitetit, në përputhje me kompetencat e tyre.
- (4) Të dhënat nga raportet mund të përdoren për planifikimin e veprimtarive të ardhshme, përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Transparenca dhe mbrojtja e të dhënave

Neni 65

- (1) Universiteti siguron informimin e duhur publik dhe transparencën e të dhënave për bashkëpunimin ndërkombëtar, në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.
- (2) Në faqen e internetit të Universitetit dhe në forma të tjera të përshatshme mund të publikohen informacione për kontratat ndërkombëtare, partneritetet, programet, projektet, mobilitetet, mundësitë për bashkëpunim dhe veprimtaritë e tjera me rëndësi për publikun akademik dhe publikun e gjerë.
- (3) Gjatë mbajtjes, përpunimit, përdorimit dhe publikimit të të dhënave sigurohet mbrojtja e të dhënave personale dhe e informacioneve konfidenciale, në përputhje me dispozitat në fuqi.
- (4) Publikimi i të dhënave bëhet në mënyrë që siguron transparencën e punës së Universitetit, pa cenuar të drejtat dhe interesat e studentëve, të të punësuarve, institucioneve partnere dhe personave të tjerë.

XIII. MBROJTJA E TË DREJTAVE, MUNDËSITË E BARABARTA DHE TRANSPARENCA

Mbrojtja e të drejtave

Neni 66

- (1) Gjatë zbatimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, Universiteti i respekton dhe i garanton të drejtat e studentëve, kuadrit akademik dhe administrativ, studentëve të huaj, kuadrit mysafir dhe pjesëmarrësve të tjerë në veprimtaritë e bashkëpunimit ndërkombëtar.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- (2) Të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve përcaktohen në përputhje me ligjin, Statutin, këtë rregullore, aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit dhe rregullat e programit, projektit ose kontratës përkatëse.
- (3) Pjesëmarrësve në bashkëpunimin ndërkombëtar u sigurohen informacione të sakta dhe në kohë për kushtet, kriteret, procedurat, afatet, të drejtat dhe detyrimet që lidhen me veprimtarinë konkrete.

Mundësitë e barabarta dhe mosdiskriminimi

Neni 67

- (1) Universiteti siguron mundësi të barabarta për pjesëmarrje në veprimtaritë e bashkëpunimit ndërkombëtar.
- (2) Përzgjedhja e pjesëmarrësve në programe, projekte, mobilitete dhe veprimtari të tjera ndërkombëtare bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht, objektive, relevante dhe transparente.
- (3) Ndalohet çdo formë diskriminimi në qasjen dhe pjesëmarrjen në veprimtaritë e bashkëpunimit ndërkombëtar, në përputhje me ligjin dhe aktet e përgjithshme të Universitetit.
- (4) Gjatë zbatimit të veprimtarive nxitet siguri i qasjes së barabartë dhe i mbështetjes së përshtatshme për personat të cilët, në përputhje me dispozitat e zbatueshme dhe rregullat e programit konkret, kanë nevojë për mbështetje shtesë.

Transparenca

Neni 68

- (1) Procedurat për pjesëmarrje në programe, projekte, mobilitete dhe veprimtari të tjera ndërkombëtare zbatohen në mënyrë transparente dhe të parashikueshme.
- (2) Informacionet për mundësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar, kushtet e pjesëmarrjes, kriteret e përzgjedhjes, afatet, rezultatet e procedurave dhe informacionet e tjera relevante publikohen në mënyrë të qasshme për personat e interesuar, në përputhje me ligjin dhe aktet e Universitetit.
- (3) Kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së kandidatëve përcaktohen dhe publikohen përpara fillimit të procedurës së përzgjedhjes.
- (4) Rezultatet e procedurave publikohen në mënyrë që siguron transparencën dhe, njëkohësisht, respekton dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

Kundërshtimi dhe mbrojtja e të drejtave

Neni 69

- (1) Kandidati ose pjesëmarrësi që konsideron se, në procedurën e përzgjedhjes, mobilitetit ose në një veprimtari tjetër nga fusha e bashkëpunimit ndërkombëtar, i është cenuar ndonjë e drejtë, mund të paraqesë kundërshtim ose të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të veta, në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.
- (2) Kundërshtimi i paraqitet organit ose personit kompetent, brenda afatit dhe në mënyrën e përcaktuar me aktet e Universitetit ose me rregullat e programit përkatës.
- (3) Paraqitja e kundërshtimit nuk mund të jetë bazë për trajtim të pafavorshëm të parashtruesit.

Mbrojtja e të dhënave personale dhe e konfidencialitetit

Neni 70

- (1) Gjatë zbatimit të veprimtarive nga fusha e bashkëpunimit ndërkombëtar, Universiteti siguron përpunimin e ligjshëm, të drejtë dhe transparent të të dhënave personale.
- (2) Të dhënat personale mblidhen, përpunohen, përdoren, ruhen dhe shkëmbehen vetëm për qëllime të përcaktuara dhe të arsyeshme dhe në masën e nevojshme për realizimin e veprimtarisë konkrete, në përputhje me dispozitat në fuqi.
- (3) Gjatë shkëmbimit të të dhënave me institucionet partnere dhe subjektet e tjera nga jashtë vendit, ndërmerren masa të përshtatshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të informacioneve konfidenciale.
- (4) Personat që marrin pjesë në zbatimin e bashkëpunimit ndërkombëtar janë të detyruar ta respektojnë konfidencialitetin e informacioneve në të cilat kanë qasje, në përputhje me detyrimet e tyre të punës dhe detyrimet e tjera.

XIV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Harmonizimi i akteve dhe veprimtarive ekzistuese

Neni 71

- (1) Kontratat ndërkombëtare, memorandumet, marrëveshjet, protokollet dhe aktet e tjera ekzistuese të bashkëpunimit, të lidhura përpara hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, vazhdojnë të zbatohen deri në përfundimin e vlefshmërisë së tyre, nëse nuk janë në kundërshtim me ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ БО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

- (2) Veprimtaritë dhe procedurat e bashkëpunimit ndërkombëtar, të filluara përpara hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, vazhdojnë në përputhje me dispozitat dhe aktet në bazë të të cilave janë filluar, përveçse kur me ligj ose me një akt tjetër përcaktohet ndryshe.
- (3) Evidencat dhe dokumentacioni ekzistues për bashkëpunimin ndërkombëtar harmonizohen me dispozitat e kësaj Rregulloreje brenda afatit të përcaktuar nga organi kompetent i Universitetit.

Miratimi i procedurave dhe formularëve të brendshëm

Neni 72

- (1) Për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje, kur është e nevojshme, miratohen procedura të brendshme, udhëzime, formularë dhe akte të tjera.
- (2) Procedurat e brendshme, udhëzimet dhe formularët nga paragrafi (1) i këtij neni miratohen në përputhje me kompetencat e përcaktuara me Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Universitetit.
- (3) Deri në miratimin e procedurave dhe formularëve të rinj të brendshëm, mund të zbatohen procedurat dhe formularët ekzistues, nëse nuk janë në kundërshtim me këtë Rregullore dhe me dispozitat dhe aktet e tjera në fuqi të Universitetit.

Pushimi i vlefshmërisë

Neni 73

- (1) Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushojnë së vlejture dispozitat e akteve të tjera të përgjithshme të Universitetit, me të cilat çështjet e rregulluara me këtë Rregullore janë rregulluar në mënyrë tjetër, nëse janë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Hyrja në fuqi

Neni 74

- (1) Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj.

Kryetari i Senatit,
Prof. Dr. Vullnet Ameti